



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHITIME



OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHITME

Zyra e kryetarit/Kancelarija predsednika/Major's office

Datë: 21/10/2025

Nr.prot: 02/ 1206

Në mbështetje të neneve 13, 17, 24 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 18 të Rregullores nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive jo financiare në Organizata Buxhetore, kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM
PËR INVENTARIZIMIN E PASURISË JO FINANCIARE PËR VITIN 2025 NË
KOMUNËN E SHITIMES

- I. Për inventarizimin e pasurisë së Komunës, Kryetari i Komunës me vendim të veçantë cakton Komisionin e Inventarizimit sipas strukturës buxhetore.
- II. Komisionet për inventarizimin e pasurisë në nivel të sektorëve duhet të dorëzojnë raporte dhe dëshmitë për inventarizimin e pasurisë së njësive të Komisionit Komunal për inventarizim që të përgatitet raporti përfundimtar i pasurisë financiare.
- III. Inventarizimi i pasurisë duhet të bëhet për vitin fiskal aktual 2025.
- IV. Inventarizimi i pasurisë duhet të përfshijë:
 - a) Inventarizimin e të gjithë pasurisë jo financiare që është në pronësi dhe në kontroll të organizatës buxhetore.
 - b) Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së pasurisë jo financiare.
 - c) Krahësimin e gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurisë jo financiare.
 - d) Identifikimin e pasurive të dëmtuara dhe jashtë funksionit.
 - e) Përgatitjen e raportit për kryerjen e inventarizimit.
- V. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrim.

Ju dërgohet:
Menaxhmentit të Komunës
Arkivit



Qemajl Aliu

Kryetari i Komunës